

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR VITIN 2026

Nr	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Përgjigje	Tarifa
1.	22.01.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në përgjigje të shkresës “Kërkesë për informacion” , më poshtë përgjigjet për secilën pikë.</p> <p>1.Kopje të Raporteve Mjedisore për vitet 2020-2025 .</p> <p>Kopje të Raporteve Mjedisore për vitet 2020-2025 . Gjenden pranë Agjensise Kombetare te Mjedisit (si institucionit ligjor per monitorimin e cilesise se ajrit apo gjithe mjedisit).</p> <p>2. Raportet mbi cilësinë e ajrit dhe nivelet e grimcave të dëmshme të nxjerra pas matjeve përkatëse, për vitet 2020-2025 .</p> <p>Raportet mbi nivelet e elementeve ndotes te cilesise se ajrit disponohen nga Agjencia Kombetare e Mjedisit</p> <p>3. Raportin për sëmundjet e shkaktuara nga nivelet e ndotjes së ajrit dhe numri i vdekjeve të shkaktuara nga kjo problematikë.</p> <p>Analizë mbi pasojat e ndotjes së ajrit në shëndet, në Shqipëri dhe Tiranë</p> <p>Ndotja e ajrit është një nga problemet më të mëdha shëndetësore dhe mjedisore në botë. Ajo zhvillohet në dy kontekste: ndotja e ajrit të brendshëm (shtëpiak) dhe ndotja e ajrit të jashtëm.</p> <p>Vlerësimi i përmasave të efektit në shëndet të ndotjes së ajrit, në Shqipëri apo në Tiranë mund të kryhet vetëm duke bërë ekstrapolime mbi gjetjet e literaturës dhe supozime të arsyeshme bazuar në nivelin real të sëmundshmërisë apo vdekshmërisë nga sëmundje të lidhura me ndotjen e ajrit në Shqipëri. Instituti i Shëndetit Publik për kryerjen e këtyre analizave bazohet në disa burime informacioni lidhur me barrën e sëmundjeve në vend, si dhe në vlerësime të kryera nga Institute of Health Metrics and Evaluation, që konsiderohet referencë ndërkombëtare në këtë fushë.</p>	Nuk ka

Efektet në shëndet të ndotjes së ajrit të brendshëm apo të jashtëm lidhen me mekanizma biologjikë që çojnë në rritjen e riskut për t'u prekur apo për të vdekur nga dhjetëra sëmundje, ndër të cilat më kryesoret janë: sëmundjet ishemike të zemrës, sëmundjet cerebrovaskulare, sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (SPOK), kanceri i mushkërive, etj. Proporcioni i vlerësuar i efektit të ndotjes së ajrit të disa sëmundjeve kryesore në vendin tonë së bashku me intervalet përkatëse të besimit është paraqitur më poshtë, në tabelën 1.

Tabela1. Proporcioni i vdekjeve që i atribuohen ndotjes së ajrit për sëmundjet kryesore të lidhura me këtë faktor rrisht, në Shqipëri

Grup-sëmundje kryesore të lidhura me ndotjen e ajrit në Shqipëri	% e vdekjeve që i atribuohet ndotjes së ajrit	Kufiri i poshtëm i besimit	Kufiri i sipërm i besimit	% që zë sëmundja në totalin e vdekjeve
Aksidente cerebrovaskulare	15,6	9,8	25,6	20,5
Sëmundje Ishemike të Zemrës	19,7	12,7	28,1	21,5
SPOK dhe astma	22,8	13,9	43,2	2,7
Kancer mushkërie	14,4	8,3	22,5	3,6


Niveli i standartizuar për moshën i vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit në Shqipëri vlerësohet të ketë rënë në mënyrë të qëndrueshme prej vitit 1990. Nga 215 vdekje për 100000 banorë në 1990 në vetëm 66 vdekje për 100000 banorë në vitin 2021 (niveli i standartizuar shërben vetëm për krahasime në kohë dhe hapësirë dhe nuk vlen për përlogaritjen e numrit real). Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e uljes së vdekshmërisë, atribuar në mënyrë specifike ajrit të brendshëm. Edhe ndikimi i ndotjes së ajrit të jashtëm duket se ka një përmirësim në dekadën e fundit, pas një rritje në periudhën 2000-2010. (Tabela 2)

Tabela 2. Niveli i standartizuar i vdekshmërisë atribuar ndotjes së ajrit në Shqipëri (për 100000 banorë)

	1990	2000	2010	2021
I jashtëm	45,1	38,4	52,8	47,9
I brendshëm	168	129,1	45,6	17,9
Ozoni	5,1	2,2	1,4	0,6
Gjithsej	215,2	168,3	99,4	66,3

Përqindja e vdekjeve atribuar ndotjes së ajrit në Shqipëri vlerësohet të jetë pak më e ulët se në vendet të Ballkanit Perëndimor dhe shumë më e ulët se në vende të tjera të Mesdheut Lindor (harta 1). Vlerësohet së ndotja e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm në Shqipëri është përgjegjëse për rreth 8,8% të të gjithë vdekjeve. Ky proporcion ka qenë 16,8% në vitin 2010, 23,7% në vitin 2000 dhe rreth 25% në vitin 1990.

Harta 1. Proporcioni i vdekjeve atribuar ndotjes së ajrit



Për të përlogaritur numrin real të vdekjeve në Shqipëri dhe në Tiranë nga sëmundjet kryesore të lidhura me ndotjen e ajrit mund të aplikojmë proporcionet e vlerësuara të efektit dhe numrat e observuar të vdekjeve (tabela 3). Theksojmë se përlogaritja bazohet në ekstrapolime mbi gjetjet e literaturës dhe supozime të arsyeshme bazuar në nivelin real të sëmundshmërisë apo vdekshmërisë nga sëmundje të lidhura me ndotjen e ajrit në Shqipëri.

Vërehet se në bashkinë Tiranë, ndotjes së ajrit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin 2024, mund t'i atribuohen 46 vdekje nga sëmundjet cerebrovaskulare, 77 vdekje nga sëmundjet ishemike të zemrës, 10 vdekje nga sëmundjet respiratore kronike dhe 21 vdekje nga kanceri i mushkërive (në total, 154


vdekje nga këto 4 grup sëmundje). Për vitin 2019, kishim përkatësisht 76 vdekje nga sëmundjet cerebrovaskulare, 84 vdekje nga sëmundjet ishemike të zemrës, 12 vdekje nga sëmundjet kronike të mushkërive dhe 28 vdekje nga kanceri i mushkërive (në total 200 vdekje nga këto 4 grup sëmundje). Nga kjo analizë konfirmohet një ulje e vdekjeve atribuar ndotjes së ajrit të brendshëm dhe të jashtëm nga viti 2019 në vitin 2024. Vitet e pandemisë janë përjashtuar nga analiza për arsye të efektit shumë të madh të Covid 19 në këto sëmundje.

Tabela 3. Vdekjet atribuar ndotjes së ajrit, për katër grup sëmundjet kryesore

		Aksidente cerebrovaskulare	Sëmundje Ishemike të Zemrës	SPOK dhe Astmë	Kancer Mushkërie	Gjithsej 4 grup-sëmundje
2019	Tirana Bashki	485	426	52	193	1156
	Atribuar ndotjes së ajrit	76	84	12	28	199
	Tirana Qark	680	647	87	239	1653
	Atribuar ndotjes së ajrit	106	127	20	34	288
	Shqipëria	3389	2803	463	853	7508
	Atribuar ndotjes së ajrit	529	552	106	123	1309
2024	Tirana Bashki	295	390	45	148	878
	Atribuar ndotjes së ajrit	46	77	10	21	154
	Tirana Qark	414	593	75	183	1265
	Atribuar ndotjes së ajrit	65	117	17	26	225
	Shqipëria	2405	2708	373	749	6235
	Atribuar ndotjes së ajrit	375	533	85	108	1102

Në grafikun 1 është paraqitur efekti i pandemisë Covid 19, vetëm për sëmundjet respiratore kronike, por ai është i ngjashëm edhe për sëmundjet e tjera.

Grafiku 1. Vdekshmëria (bruto dhe e standartizuar) nga sëmundjet respiratore kronike në Shqipëri, para dhe pas pandemisë



Në Shqipëri rezultojnë të regjistruar në sistemin shëndetësor 46869 persona të diagnostikuar me sëmundje kronike të mushkërive, prej të cilëve 14814 janë në qarkun e Tiranës.

2. 29.01.2026

Kerkese per informacion

Objekti i kërkesës: Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni

Drejtuar: Xhesika Tollia dhe Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri.

Duke iu përgjigjur kërkesës tuaj mbi ndotjen e ajrit dhe ndikimet e saj në shëndetin e qytetarëve, vijojnë përgjigjet mbi masat, planet strategjike dhe vlerësimin e situatës aktuale të cilësisë së ajrit dhe efekteve shëndetësore.

- *Çfarë masash ka marrë Ministria e Shëndetësisë për të mbrojtur qytetarët nga ndotja e ajrit dhe cili është efekti i tyre deri më tani?*

Nuk ka

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me institucionet e tjera të qeverisë dhe agjencitë mjedisore, ka përfshirë ndotjen e ajrit në prioritetet e mbrojtjes së shëndetit publik, megjithëse përgjegjësia kryesore për politikën e cilësisë së ajrit është nën Ministrinë e Turizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Për këtë arsye:

Masat kryesore të ndërmarra nga Ministria dhe autoritetet shëndetësore

a. Monitorim i shëndetit publik dhe rrezikut nga ajri i ndotur

Ministria ka integruar shqetësimet për ndotjen e ajrit brenda rekomandimeve të shëndetit publik, duke i lidhur ato me sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare që shfaqen nga grimcat dhe ndotësit në ajër (bazuar në vlerësimet mjedisore për ndikimin mbi shëndetin e njerëzve).

b. Strategji dhe koordinim ndërinstytucional

Ekziston një Strategji Kombëtare për Cilësinë e Ajrit dhe plane kombëtare që synojnë përmirësimin e mjedisit, ku Ministria e Shëndetësisë bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për të adresuar ndikimet shëndetësore dhe për të informuar publikun.

c. Fushata ndërgjegjësimi dhe komunikim publik

Aktivitete të përbashkëta informative dhe udhëzime për qytetarët lidhur me ekspozimin ndaj ajrit të ndotur, përfshirë rekomandime për grupet më vulnerabël (fëmijë, të moshuar, personat me sëmundje kronike). Këto fushata shpesh realizohen në partneritet me organizata ndërkombëtare dhe shoqata civile.

Një shembull konkret është komunikimi me bashkinë e Tiranës dhe rrekomandimet që ISHP ka dhënë për cilësinë e ajrit si më poshtë:

Për zbutjen e ndotjes së ajrit rekomandimet kryesore janë:

1. Përmirësimi i transportit urban
2. Menaxhimi i ndotjes industriale
3. Monitorimi dhe kontrolli i ndotjes së cilësisë së ajrit
4. Ndërhyrje në bujqësi dhe djegie të mbeturinave
5. Përfshirja e publikut dhe edukimi i tij
6. Mbështetje në politika dhe legjislacion.

d. Pjesëmarrja në plane mjedisore & bashkëpunime ndërkombëtare

Ministria dhe institucionet shëndetësore mbështesin objektivat kombëtarë për reduktimin e ndotjes dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian, përfshirë rishikimin e strategjive dhe angazhimin për uljen e emetimeve nga burimet kryesore.

Efekti i këtyre masave ka pasur përmirësime mesatare, sidomos në uljen e vdekshmërisë së lidhur me ndotjen, por sfidat mbeten të mëdha për sa i përket monitorimit dhe zbatimit të politikave të cilësisë së ajrit.

➤ ***A ka plane strategjike Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e sëmundjeve të lidhura me ndotjen e ajrit dhe uljen e vdekshmërisë?***

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka plane strategjike që adresojnë parandalimin e sëmundjeve dhe uljen e vdekshmërisë, edhe pse këto nuk janë të fokusuar vetëm tek ndotja e ajrit si temë e veçantë:

- Strategjia Kombëtare e Shëndetit dhe dokumente të tjera shëndetësore përfshijnë objektiva të gjerë për parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme – e cila përfshin sëmundjet respiratore dhe zemër-gjakut që lidhen me faktorët mjedisorë, përfshirë ndotjen e ajrit. Këto dokumente synojnë forcimin e shërbimeve të kujdesit parësor, promovimin e shëndetit dhe uljen e barrës së sëmundjeve kronike, që janë të ndikuara edhe nga cilësia e ajrit.
- Brenda dokumenteve të Strategjisë Kombëtare të Shëndetit 2021-2030 dhe programeve për sëmundjet jo të transmetueshme, ka përfshirë edhe elemente të përgjithshme të promovimit të ambientit të pastër dhe reduktimit të rreziqeve mjedisore për shëndetin, edhe pse ndotja e ajrit nuk është e shkëputur si objektiv kryesor, ajo trajtohet në kontekstin e faktorëve të rrezikut që ndikojnë në shëndetin e popullatës.

➤ **Si i vlerëson Ministria e Shëndetësisë nivelet e ndotjes së ajrit në Shqipëri krahasuar me standardet kombëtare dhe ato të OBSH-së?**

Ministria e Shëndetësisë e sheh ndotjen e ajrit në Shqipëri si një problem serioz shëndetësor. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nivelet e grimcave PM2.5 shpesh tejkalojnë tre herë kufirin e rekomanduar nga OBSH-ja dhe në disa qytete tejkalojnë edhe standardet kombëtare. Ministria fokusohet në vlerësimin e ndikimit në shëndet, ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe mbështetjen e masave për parandalimin e sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare

3.	05.02.2026	Kerkese per informacion	<p>Lidhur me përbërësit e vaksinave të detyrueshme sipas Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit.</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj, bashkëlidhur këtij emaili po ju përcjellim një tabelë orientuese, ku pasqyrohen vaksinat e detyrueshme sipas kalendarit të vaksinimit dhe emri i prodhuesit nga i cili institucioni ynë siguron secilën vaksinë.</p> <p>Ju bëjmë me dije se, në varësi të procedurave të prokurimit dhe disponibilitetit ndërkombëtar, prodhuesi i një vaksine të caktuar mund të ndryshojë, ndërkohë që të gjitha vaksinat e përdorura janë të miratuara dhe plotësojnë standardet e sigurisë dhe cilësisë të përcaktuara nga autoritetet përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, ju informojmë se vaksinat e përfshira në Kalendarin Kombëtar të Vaksinimit janë të parakualifikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe të miratuara nga agjenci të akredituara rregullatore të barnave në vendet përkatëse prodhuese, duke garantuar kështu efikasitetin, sigurinë dhe cilësinë e tyre.</p> <table border="1" data-bbox="527 813 1724 1312"> <thead> <tr> <th>Vaksinat</th> <th>Emri i Prodhuesit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>BCG</td> <td>BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria</td> </tr> <tr> <td>DTP-HepB-Hib-1 (lq)</td> <td>Biological E.Limited -India</td> </tr> <tr> <td>HepB-1 pediatric</td> <td>Serum Life Sciences Ltd-Made in India</td> </tr> <tr> <td>DTP</td> <td>Biological E.Limited -India</td> </tr> <tr> <td>DT</td> <td>BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria</td> </tr> <tr> <td>Td</td> <td>BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria</td> </tr> <tr> <td>bOPV</td> <td>P.T Bio Farma (Persero)-Indonesia</td> </tr> <tr> <td>IPV</td> <td>Bilthoven Biologicals B.V-Bilthoven, Netherlands</td> </tr> <tr> <td>MMR</td> <td>Merc Sharp & Dohme Corp.-Durham,NC, USA</td> </tr> <tr> <td>PCV13</td> <td>PFIZER INC-Belgium</td> </tr> <tr> <td>RV5</td> <td>Serum Institute of India -India</td> </tr> <tr> <td>HPV 4</td> <td>Merc & Co. -Rahway, NJ,USA</td> </tr> </tbody> </table>	Vaksinat	Emri i Prodhuesit	BCG	BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria	DTP-HepB-Hib-1 (lq)	Biological E.Limited -India	HepB-1 pediatric	Serum Life Sciences Ltd-Made in India	DTP	Biological E.Limited -India	DT	BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria	Td	BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria	bOPV	P.T Bio Farma (Persero)-Indonesia	IPV	Bilthoven Biologicals B.V-Bilthoven, Netherlands	MMR	Merc Sharp & Dohme Corp.-Durham,NC, USA	PCV13	PFIZER INC-Belgium	RV5	Serum Institute of India -India	HPV 4	Merc & Co. -Rahway, NJ,USA	Pa pagese
Vaksinat	Emri i Prodhuesit																													
BCG	BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria																													
DTP-HepB-Hib-1 (lq)	Biological E.Limited -India																													
HepB-1 pediatric	Serum Life Sciences Ltd-Made in India																													
DTP	Biological E.Limited -India																													
DT	BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria																													
Td	BB-NCIPD EAD-Sofia, Bulgaria																													
bOPV	P.T Bio Farma (Persero)-Indonesia																													
IPV	Bilthoven Biologicals B.V-Bilthoven, Netherlands																													
MMR	Merc Sharp & Dohme Corp.-Durham,NC, USA																													
PCV13	PFIZER INC-Belgium																													
RV5	Serum Institute of India -India																													
HPV 4	Merc & Co. -Rahway, NJ,USA																													

4.	17.02.2026	Kërkesë për informacion	<p>Lidhur me Liqenin Artificial të Tiranës dhe Rezervuarin e Tufinës:</p> <p>Çështjet që lidhen me inspektimet për ndotje ujore, shkelje të kushteve të sigurisë, marrjen e masave administrative, si dhe administrimin dhe monitorimin e ujërave sipërfaqësore, përfshirë liqenet dhe rezervuarët, nuk bëjnë pjesë në kompetencat funksionale të Institutit të Shëndetit Publik.</p> <p>Referuar kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht Ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, dhe Ligjit nr. 29/2024, “Për Burimet Ujore”, monitorimi mjedisor i ujërave sipërfaqësore, kontrolli i ndotjes, inspektimet dhe marrja e masave administrative janë kompetencë e institucioneve përgjegjëse në fushën e mjedisit dhe të menaxhimit të burimeve ujore.</p> <p>Instituti i Shëndetit Publik ushtron funksionet e tij në fushën e mbrojtjes së shëndetit publik, në përputhje me legjislacionin përkatës, dhe nuk është autoritet inspektues apo administrativ për ujërat sipërfaqësore, si dhe nuk ka kompetencë për vendosjen e masave administrative ndaj njërive të qeverisjes vendore.</p> <p>Për sa më sipër, për çështjet e ngritura në e-mail-in me lëndë: “Kërkesë për informacion”, të datës 17.02.2026, sugjerojmë që t’u drejtoheni institucioneve përgjegjëse në fushën e mjedisit dhe të menaxhimit të burimeve ujore, si dhe autoriteteve vendore përkatëse.</p>	Nuk ka
5.	17.02.2026	Kërkesë për informacion	<p>Në vijim të kërkesës për informacion për sigurinë ushqimore:</p> <p>Në përputhje me Ligjin nr. 10138/2009 “Për Shëndetin Publik”, Ligjin nr. 9863 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin vjetor të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për miratimin e “Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inputet bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në pikat e inspektimit kufitar”, kontrollet zyrtare të ushqimit, marrja dhe analizimi i mostrave, masat administrative, bllokimet/asgjësimet dhe raportet përkatëse nuk bëjnë pjesë në kompetencat e Institutit të Shëndetit Publik.</p> <p>Këto funksione realizohen dhe raportohen nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar të ushqimit, i cili administron të gjitha të dhënat e kërkuara në pikat 1–7 dhe 10 të kërkesës suaj.</p>	Nuk ka

			<p>ISHP ushtron vetëm funksionet ligjore të vlerësimit të riskut për shëndetin publik, survejancës epidemiologjike dhe mbledhjes së të dhënave në nivel popullate, në varësi të informacionit të siguruar nga monitorimi zyrtar i ushqimeve.</p> <p>Për periudhën 2014–2025, ISHP nuk disponon vlerësim të dedikuar të ekspozimit ndaj AFB1 nga drithërat, as raporte specifike epidemiologjike që lidhin ekspozimin kronik ndaj aflatoksinave me incidencën e kancerit në Shqipëri, në mungesë të disponueshmërisë së një baze të plotë monitorimi nga autoriteti përgjegjës.</p> <p>Për informacion të detajuar mbi mostrat, analizat, tejkalimet, masat administrative, produktet e bllokuara apo planet e monitorimit, ftojme Emisionin investigativ “Vetting” t’i drejtohet autoritetit kompetent për kontrollin zyrtar të ushqimit.</p> <p>Sektori i Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes në Institutin e Shëndetit Publik mbetet në dispozicion për të ofruar çdo informacion që përfshihet në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të përcaktuara me ligj.</p>	
6.	03.03.2026	Kërkesë për informacion	<p>1. A ofrohen aktualisht në Shqipëri trajtimi profilaktik para-ekspozimit (PrEP) për parandalimin e infeksionit HIV dhe trajtimi profilaktik pas-ekspozimit (PEP)?</p> <p>Në strukturat shëndetësore publike, profilaksia para ekspozimit (PrEP) aktualisht nuk ofrohet, ndërsa profilaksia pas ekspozimit (PEP) është e disponueshme dhe ofrohet për të rriturit dhe foshnjat e ekspozuar ndaj HIV.</p> <p>2. Nëse trajtimet e mësipërme ofrohen, kërkoj të informohem mbi:</p> <p>a. Cilat janë kushtet që duhet të plotësojë një individ për të përfituar nga këto trajtime?</p> <p>Kushtet dhe kriteret për dhënien e PEP vlerësohen nga mjeku infeksionist në shërbimin e sëmundjeve infektive.</p> <p>b. Cili institucion shëndetësor i ofron?</p>	Nuk ka

PEP ofrohet në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive për të rritur, dhe në Shërbimin e Pediatriisë për fëmijet.

c. Sipas cilave akte ligjore apo nënligjore janë përcaktuar këto kushte?

Ofrimi i PEP mbështetet në Ligjin Nr. 9952, datë 14.7.2008 “PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E HIV/AIDS-IT”; <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/07/14/9952>

dhe në

Vendim i KM nr.113, datë 17.2.2011 “Për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS-it dhe për kujdesin, këshillimin dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS në institucionet e arsimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, burgjet dhe vendet e paraburgimit”

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2011/23/60d6b6b7-67be-45fc-8e36-1abb93a6a799>

3. Nëse trajtimi PrEP dhe/ose PEP ofrohet në Shqipëri, sa ka qenë numri i përfituesve për secilin prej këtyre trajtimeve gjatë pesë viteve të fundit (i ndarë sipas vitit)?

Ky informacion nuk disponohet nga Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat përkatëse mund të jenë të disponueshme pranë strukturave që ofrojnë këtë shërbim.

4. A ofrohet vaksina kundër HPV-së në Shqipëri në kuadër të programeve të vaksinimit publik?

Po. Vaksina ndaj HPV është pjesë e Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit në Shqipëri, ofrohet me një dozë dhe falas në qendrat shëndetësore.

5. Nëse vaksina kundër HPV-së ofrohet në Shqipëri, lutem të më vendosni në dispozicion kategoritë dhe grupmoshat e targetuara për vaksinim, si dhe numrin e personave të vaksinuar kundër HPV-së në pesë vitet e fundit?

Nga 1 Nëntor 2022, vaksina ndaj HPV aplikohet për vajzat 13 vjeç dhe nga 1 Janari 2026: Programi është zgjeruar edhe për djemtë 13 vjeç.

			Nga 1 Nëntor 2022 deri më 2 Mars 2026, janë administruar në total 49,000 doza të vaksinës ndaj HPV në rang kombëtar.	
7.	05.03.2026	Kërkesë për informacion	<p>Kërkesë ër informacion në lidhje me helmimet nga ujin për periudhën 2024-2025:</p> <p>Për vitin 2024-2025 nuk ka patur raste helmimesh ose sëmundjesh me origjinë hidrike të raportuara.</p> <p>- Raportet e monitorimit të jashtëm të cilësisë së ujit të pijshëm janë në përgjegjësi të strukturës rajonale të shëndetit publik.</p> <p>-Referuar dhe në zbatim të VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores ‘Cilësia e ujit të pijshëm’”, neni 21, këto raporte (për vitet 2024 dhe 2025) mund të merren pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSh) Tiranë.</p>	Nuk ka